



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Më datë: 10.03.2016

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 29, të datës 07.03.2016 i marrë në mbledhjen Kuvendit të Komunës të datës 29.02.2016, më datë 10.03.2016 lidhet:

**MARRËVESHJE E BASHKËPUNIT
PËR
KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT**

Ndërmjet palëve:

Komunës së Fushë-Kosovës me adresë në rrugën “Nënë Tereza” në Fushë-Kosovë,
të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Burim Berisha

dhe

Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, të cilën e përfaqëson Kryetari - Pajazit Tërnavë.

Neni 1

Me anë të kësaj marrëveshjeje të dyja palët janë të pajtimit të rregullojnë kryerjen e shërbimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm të komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 2

Komuna e Fushë-Kosovës për të ndihmuar qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, autorizon dhe bart në përgjegjësi të Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë kryerjen e shërbimeve të varrimit në tërë territorin e komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 3

1. Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë obligohet që të kryej punë për shërbimet e varrimit, të cekura në vijim:

- 1.1. Pastrimi i kufomës (pastrimi, mbështjellja dhe përgatitja e kufomës sipas rregullave islame nga personi përgjegjës) – në shumë prej 65€,
- 1.2. Dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr, me dimensione 2.00 x 1.15 x 0.05, në shumë prej 50€,

- 1.3.Qefini (pëlhura për mbështjelljen e kufomës, ku përfshihen dorezat higjienike, pambuku dhe sapuni), në shumë prej 50€,
- 1.4.Vendpastrimi i kufomës (banjë moderne për pastrimin e kufomës), në shumë prej 50€,
- 1.5.Shërbimi i Imamit, në shumë prej 60€,
- 1.6.Kryerja e riteve fetare te varrezat dhe shërbimet tjera, në shumë prej 35€,
- 1.7.Mbulesa e kufomës (pëlhura me citate të Kur'anit e cila vendoset mbi pëlhurën që është mbështjellë kufoma), në shumë prej 25€.
2. Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare sipas nenit 3, paragrafi 1, pikat 1.1 deri në 1.7 për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Komuna dhe Këshilli i Bashkësisë Islame, është në shumë prej 335€ për çdo person që ndërron jetë.

Neni 4

Komuna e Fushë-Kosovës obligohet që për shërbimet e varrimit (pastrimin e kufomës, dërrasat dhe qefinin) të paguaj shumën prej 165€ për çdo ceremoni varrimi.

Neni 5

Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë obligohet që për shërbimet e varrimit (vend- pastrimin e kufomës, shërbimin e Imamit, kryerjen e riteve fetare te varrezat dhe mbulesën e të vdekurit) të paguaj shumën e mjeteve prej 170€ për çdo ceremoni varrimi.

Neni 6

Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë obligohet që për çdo muaj t'i raportojë Komunës së Fushë-Kosovë për rastet e vdekjes dhe çdo shpenzim të mjeteve nga buxheti i komunës të arsyetojë përmes faturimit, me kohë, për pagesën e shërbimeve të kryera.

Neni 7

Komuna e Fushë Kosovës obligohet që në xhirollogarinë e Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë Nr. 20-14-0000524964-84 në TEB Bankë, t'i transferojë mjetet financiare, në shumë prej 165€ për çdo ceremoni varrimi, ndihmë në mbulimin e shpenzimeve të varrimit për çdo person që ndërron jetë.

Neni 8

Komuna e Fushë-Kosovës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë me anë të kësaj marrëveshjeje marrin për obligim pagesën e shërbimeve të parapara sipas kësaj marrëveshjeje, ndërsa

qytetarëve iu mbetet përgjegjësi pagesa e anëtarësisë së KBI-së si dhe shërbimet shtesë të cilat nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Komuna e Fushë-Kosovës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë mbajnë të drejtën e shkëputjes së marrëveshjes në rast se nuk përmbushin obligimet që dalin nga kjo marrëveshje.

Neni 10

Në raste konteksti lidhur me këtë marrëveshje, kompetente për zgjidhje do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 11

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës, Nr. 29, të datës 07.03.2016, periudha e plotfuqishmërisë së marrëveshjes është nga data 29.02.2016 e deri më datë 31.12.2016, me mundësi vazhdimi.

Neni 12

Kjo marrëveshje është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilën palë.

Data e nënshkrimit 11.03.2016

Për Këshillin e Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë

Kryetari – Pajazit Tërnaj



Për Komunën e Fushë-Kosovës

Kryetar i Komunës – Burim Berisha

